




Republika e Kosovës
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

RAPORTI VJETOR PËR GJENDJEN E AJRIT 2024



Hyrje

Ky raport paraqet të dhënat mbi cilësinë e ajrit për vitin kalendarik 2024, të mbledhura nga 12 stacione matëse statike dhe një stacion mobil, të shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Raporti përmbledhë informacion mbi gjendjen dhe emisionet e ajrit, investimet në sektorin e ajrit, si dhe kornizën ligjore ekzistuese. Gjithashtu, ofron rekomandime për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë.

Të dhënat janë mbledhur nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Të dhënat e mbledhura nga këto stacione përpunohen dhe ndihmojnë në vlerësimin e përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe evropiane për cilësinë e ajrit, informimi i publikut mbi nivelet e ndotjes dhe rreziqet potenciale për shëndetin. Të dhënat ndihmojnë hartimin e politikave dhe masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Parametrat e cilësisë së ajrit që janë vlerësuar përfshijnë:

- Monoksidin e karbonit (CO)
- Ozonin (O₃)
- Dyoksidin e sulfurit (SO₂)
- Dyoksidin e azotit (NO₂)
- Grimcat e pluhurit me madhësi më të vogël se 10 dhe 2.5 mikron (PM₁₀ dhe PM_{2.5})

Ndërsa të dhënat për shkarkimet nga industritë përfshijnë vlerësimet e emisioneve të oksideve të azotit (NO_x), dioksidit të squfurit (SO₂) dhe pluhurit total, nga operatorët ekonomikë: TCA, TCB, New Co Feronikel dhe Sharr Cem.

Analiza e të dhënave është realizuar nga Divizioni për Vlerësim të Gjendjes Mjedisore, në kuadër të Drejtorisë për Vlerësim të Gjendjes së Mjedisit pranë Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës / MMPHI.

Përmbajtja

1. Infrastruktura ligjore e ajrit

- 1.1. Korniza ligjore
- 1.2. Informimi për kufijtë e alarmit për cilësi të ajrit
- 1.3. Ndotësit e ajrit

2. Cilësia e ajrit

- 2.1. Monitorimi i cilësisë së ajrit
- 2.2. Aglomeracionin AKS1 - cilësia e ajrit
- 2.3. Zona ZKS1 - cilësia e ajrit
- 2.4. Ditët me tejkalime për PM₁₀ gjatë vitit 2024
- 2.5. Trendi i cilësisë së ajrit për vitet 2013-2024

3. Vlerësimi i emisioneve ndotëse nga operatorët për vitin 2024

- 3.1. Emisionet në ajër nga Termocentralet Kosova A dhe Kosova B
- 3.2. Emisionet në ajër nga Sharrçemi
- 3.3. Aktivitetet e Ferronikelit për vitin 2024

4. Investimet në sektorin e ajrit

5. Efektet e ndotjes së ajrit në shëndet

6. Rekomandimet

7. Lista e shkurtesave

8. Lista e figurave

9. Lista e tabelave

1. Infrastruktura ligjore e ajrit

1.1. Korniza ligjore

Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja LIGJI NR. 08/L-025, 2022 është ligji bazë për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Infrastruktura ligjore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është e plotësuar edhe me UA (akte nënligjore), si.:

- ✓ Udhëzimi administrativ MMPHI nr. 09/2023 për mënyrën e monitorimit të cilësisë së ajrit, mbledhjen e të dhënave, kriteret dhe metodologjinë;
- ✓ Udhëzimi administrativ (MMPHI) nr. 16 /2024 për vlerat kufitare, vlerat e synuara, pragjet e alarmit për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër
- ✓ Udhëzimi administrativ (QRK)–Nr.07/2021) mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- ✓ Udhëzimi administrativ (QRK) Nr.04/2009) për kontrollin e emisioneve të bashke dyzimeve organike, të avullueshme gjatë deponimit, zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve;
- ✓ Udhëzimi administrativ (QRK) Nr.16/2013 për substancat, që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara;
- ✓ Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.19/2013 për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin CO2 të automjeteve të reja personale;
- ✓ Udhëzimi administrativ (QRK)-Nr.01/2016 për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serrë.

1.2. Informimi për kufijtë e alarmit për cilësi të ajrit

Informimi dhe kufijtë e alarmit për cilësi të ajrit janë të përcaktuar sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 dhe UA 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit (*Tabela.1*).

Tabela 1. Vlerat e pragut alarmues për PM_{10} , O_3 , NO_2 , SO_2

Ndotësi	Alarmi	Pragu Alarmues
PM_{10}	100 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (në 24 orë)	100 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (në 24 orë për 3 ditë rresht)
O_3	180 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (në 1 orë)	240 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (në 1 orë)
NO_2	—	400 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (në 1 orë)
SO_2	—	500 $\mu\text{g}/\text{m}^3$ (në 1 orë)

1.2. Ndotësit e ajrit

Ndotësit e ajrit përbëjnë një sfidë të rëndësishme mjedisore dhe shëndetësore, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në cilësinë e ajrit dhe mirëqenien e popullatës. Identifikimi dhe monitorimi i ndotësve kryesorë të ajrit në nivel lokal është thelbësorë për vlerësimin e rreziqeve shëndetësore dhe ndikimeve ekologjike, si dhe për zhvillimin e politikave efektive për kontrollin dhe reduktimin e ndotjes. Në tabelën e mëposhtme paraqiten ndotësit kryesorë të ajrit që monitorohen në nivel vendi, si dhe ndikimet e tyre mbi shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. (tabela 2.)

Tabela 2. Ndotësit e ajrit dhe efektet e tyre në mjedis dhe shëndet

Ndotësi	Efektet në mjedis	Efektet në shëndet
PM₁₀	Ndikojnë negativisht në tokë, ujëra dhe vegjetacion, duke shkaktuar degradim të ekosistemeve dhe ndotje të burimeve natyrore.	Irritojnë rrugët e frymëmarrjes, shkaktojnë kollë, bronkit dhe përkeqësim të sëmundjeve të astmës.
PM_{2.5}	E ul cilësinë e ajrit dhe dëmton vizibilitetin (dukshmërinë) duke shkaktuar mjegullim atmosferik, me ndikim në ekosistemet lokale.	Depërtojnë thellë në mushkëri dhe qarkullimin e gjakut, duke rritur rrezikun për sëmundje kardiovaskulare dhe pulmonare.
CO	Ndikimi i drejtpërdrejtë në mjedis është i kufizuar, por kontribuon në ndotjen e përgjithshme të ajrit dhe formimin e ozonit troposferik.	Lidhet me hemoglobinën dhe redukton aftësinë e gjakut për transportin e oksigjenit, duke shkaktuar lodhje, marrje mëndësh dhe në raste të rënda, vdekje.
O₃	Dëmton bimët dhe ul prodhimtarinë bujqësore, duke ndikuar negativisht në ekosistemet natyrore.	Irriton sytë, fytin dhe mushkëritë, duke përkeqësuar sëmundjet respiratorë.
SO₂	Shkakton reshje acidike që dëmtojnë pyjet, tokën dhe ujin, duke çuar në degradimin e habitatit natyror.	Shkakton irritim të rrugëve të frymëmarrjes, astmë dhe sëmundje kronike pulmonare.
NO₂	Ndihmon në formimin e ozonit dhe reshjeve acidike, duke dëmtuar ekosistemet dhe cilësinë e ujit dhe tokës.	Dëmton sistemin respirator dhe rrit ndjeshmërinë ndaj infeksioneve të frymëmarrjes.

2. Cilësia e Ajrit

2.1. Monitorimi i Cilësisë së Ajrit

Monitorimi i cilësisë së ajrit është një komponent thelbësor për vlerësimin e ndikimit të ndotjes në shëndetin publik dhe mjedisin. Në kuadër të sistemit kombëtar të monitorimit, territori ndahet në dy njësi kryesore monitoruese: **Aglomeracioni AKS1** dhe **Zona ZKS1**.

- **Aglomeracioni AKS1** përfshin zonat urbane dhe industriale më të dendura, ku ndotja e ajrit paraqet risk më të lartë për popullatën. Në këtë zonë, cilësia e ajrit monitorohet në mënyrë të vazhdueshme në **6 stacione monitorimi (IHMK, Rilindje – Prishtinë, Palaj, Obiliq, Dardhishtë, Kodra e Trimave)**, të pajisura me teknologji të avancuar për matjen e grimcave të ngurta (PM_{10} , $PM_{2.5}$), dhe gazeve ndotëse (CO , NO_2 , SO_2 , O_3).
- **Zona ZKS1** përfshinë pjesë të tjera të territorit që nuk klasifikohen si aglomerate urbane të mëdha, por ku monitorimi mbetet po aq i rëndësishëm për të vlerësuar prirjet rajonale të ndotjes. Në këtë zonë janë vendosur **7 stacione monitorimi (Drenas, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Brezovicë, Hani Elezit, Gjilan)**, të shpërndara në mënyrë strategjike për të mbuluar sa më mirë hapësirën gjeografike dhe për të siguruar të dhëna të besueshme për analizat krahasuese. (*Shiko Hartën*).




Fig.1. Lokacionet e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit

2.2. Aglomeracionin AKS1 - Cilësia e ajrit

PM₁₀

Ky parametër është monitoruar në të gjitha lokalitetet e Aglomeracionit AKS1. Analiza e të dhënave për PM₁₀ nga të gjitha stacionet monitoruese, tregojnë se tejkalimi i standardit vjetor prej 40 µg/m³ është regjistruar vetëm në stacionin e Rilindjes gjatë muajit janar, ku mesatarja mujore ka arritur vlerën 44 µg/m³. (shiko tabelën 3).

Tabela 3. Vlerat mesatare mujore të PM₁₀ në AKS1, 2024

Muaj	IHKK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhishte	Kodra e Trimave
Janar	30	44	20	36	20	38
Shkurt	23	35	21	30	22	29
Mars	16	26	14	19	13	20
Prill	15	23	13	17	14	17
Maj	10	17	8	9	8	10
Qershor	14	23	12	12	12	11
Korrik	12	23	14	14	18	12
Gusht	13	23	16	13	18	18
Shtator	12	22	12	17	13	17
Tetor	18	13	14	23	20	23
Nentor	26	35	21	27	28	34
Dhjetor	33	38	17	32	19	36
Mes. 2024	18.5	26.83	15.17	20.75	17.08	22.08

Ndërsa mesatarja vjetore për parametrin PM₁₀, ka rezultuar brenda standardit vjetor prej 40 µg/m³. (Shiko Fig. 2.)




Fig. 2. Mesataret vjetore të PM₁₀ në AKS1, 2024

PM_{2.5}

Vlerat më të larta të këtij parametri janë regjistruar në stacionet monitoruese si më poshtë:

- IHMK në Prishtinë (dhjetor),
- Rilindje në Prishtinë (janar, nëntor, dhjetor),
- Obiliq (janar, nëntor, dhjetor,) dhe
- Kodra e Trimave (janar, nëntor, dhjetor,). (shiko tabelën 4).

Tabela 4. Vlerat mesatare mujore të PM_{2.5} në AKS1, 2024

Muaj	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhishte	Kodra e Trimave
Janar	24	34	16	32	22	32
Shkurt	17	24	13	25	16	22
Mars	11	17	9	13	10	15
Prill	8	12	6	10	7	9
Maj	6	10	5	6	5	7
Qershor	8	11	6	7	6	7
Korrik	8	12	8	8	8	7
Gusht	8	12	8	8	8	10
Shtator	8	12	7	9	7	10
Tetor	13	18	10	16	13	16
Nëntor	21	27	17	26	23	27
Dhjetor	25	29	14	25	18	29
Mes. 2024	13.08	18.17	9.92	15.42	11.92	15.92

Vlerat e PM_{2.5} gjatë vitit ka qenë brenda standardit vjetor që është 25 µg/m³. (shiko fig. 3).




Fig. 3. Mesataret vjetore të PM_{2.5} në AKS1, 2024

Ozoni (O₃)

Gjatë vitit është realizuar edhe monitorimi i parametrin O₃. Vlerat përmes tabelës më poshtë paraqesin mesataren mujore dhe vjetore të këtij parametri.

Nivele më të larta të O₃ janë vërejtur në disa lokalitete gjatë muajve të ndryshëm: Rilindje, Palaj, Obiliq, Dardhishtë dhe Kodra e Trimave, veçanërisht gjatë (prill, maj, qershor, korrik, gusht dhe shtator). (shiko tabelën 5).

Tabela 5. Vlerat mesatare mujore të O₃ në AKSI, 2024

Muaj	IHKM	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhishtë	Kodra e Trimave
Janar	30	19	65	34	41	34
Shkurt	40	35	48	38	29	54
Mars	48	55	52	50	50	58
Prill	54	63	55	58	54	69
Maj	51	60	49	56	54	68
Qershor	50	63	52	60	60	71
Korrik	57	76	67	70	70	82
Gusht	51	75	66	70	67	88
Shtator	36	50	42	43	47	65
Tetor	23	31	27	25	29	43
Nentor	16	26	24	20	24	43
Dhjetor	14	20	21	20	19	26
Mes. 2024	39.17	47.75	47.33	45.33	45.33	58.42

Vlera standarde e O₃ për vit është 120 µg/m³, ndërsa gjatë gjithë vitit në AKSI kjo vlerë ishte nën normën e lejuara standarde (shiko fig. 4).




Fig. 4. Mesataret vjetore të O₃ në AKSI, 2024

Dyoksidi i Sulfurit (SO₂)

Parametër SO₂ është monitoruar dhe sipas të dhënave të grumbulluara nga stacionet monitoruese nuk është regjistruar asnjë tejkalim i vlerës standarde prej 125 µg/m³ gjatë këtij viti.

Tabela 6. Vlerat mesatare mujore të SO₂ në AKSI, 2024

Muaj	IHKM	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhishtë	Kodra e Trimave
Janar	17	3	19	22	11	10
Shkurt	17	15	16	9	10	9
Mars	15	15	8	6	7	6
Prill	14	17	12	8	5	6
Maj	15	18	15	12	5	4
Qershor	20	23	20	14	5	10
Korrik	25	24	24	18	7	10
Gusht	13	4	5	12	10	9
Shtator	4	5	1	6	4	7
Tetor	13	6	2	10	4	9
Nëntor	8	8	1	12	6	10
Dhjetor	26	10	2	11	9	9
Mes. 2024	15.58	12.33	10.42	11.67	6.92	8.25

Sasia e SO₂ të monitoruar brenda vlerës standarde vjetore është paraqitur në figurën 5.




Fig. 5. Mesatare vjetore të SO₂ në AKSI, 2024

Dyoksidi i Azotit (NO₂)

Prezenca e NO₂ në cilësinë e ajrit nuk ka shfaqur vlera problematike, nga të dhënat në stacionet monitoruese është konstatuar se nuk ka pasur tejkalim të vlerave të lejuara të këtij parametri.

Tabela 7 paraqet mesataret mujore dhe vjetore të NO₂. Nivele më të larta të NO₂ janë regjistruar në stacionet monitoruese tek IHMK, Rilindja dhe Kodra e Trimave (shiko tabelën 7).

Tabela 7. Vlerat mesatare mujore të NO₂, në AKS1, 2024

Muaj	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhishte	Kodra e Trimave
Janar	31	16	13	14	13	27
Shkurt	28	15	10	12	9	22
Mars	22	13	8	9	5	19
Prill	24	14	8	8	4	18
Maj	18	10	6	5	3	14
Qershor	23	10	6	6	3	15
Korrik	28	11	7	8	4	25
Gusht	35	13	9	9	5	10
Shtator	29	11	8	8	4	9
Tetor	32	10	9	10	5	12
Nentor	33	27	11	11	5	19
Dhjetor	34	28	11	11	5	18
Mes. 2024	28.08	14.83	8.83	9.25	5.42	17.33

Ndërsa mesatarja vjetore e NO₂, ka qenë nën vlerat e lejuara të vlerës standarde 40 µg/m³ (shiko fig.6).




Fig. 6. Mesataret vjetore të NO₂, në AKS1, 2024

Monoksidi i Karbonit (CO)

Monoksidi i Karbonit (CO) në bazë të dhënave të vlerësuar nuk ka tejkaluar vlerat kufitare të lejuara për vit. Mirëpo bazuar në vlerat mujore, nivele me të larta të CO janë vërejtur në stacionet e monitorimit të IHMK, Obiliq dhe Dardhishtë (shiko tabelën 8).

Tabela 8. Vlerat mesatare mujore të CO, në AKS1, 2024

Muaj	IHMK	Rilindje	Palaj	Obiliq	Dardhishte	Kodra e Trimave
Janar	1.8	0.8	0.1	1.4	2	0.7
Shkurt	1	0.3	0.1	1.2	2.3	0.4
Mars	0.8	0.2	0.1	1	0.7	0.3
Prill	0.5	0.3	0.2	0.9	0.6	0.2
Maj	0.5	0.3	0.5	0.8	0.8	0.1
Qershor	0.5	0.3	0.8	0.8	0.7	0.1
Korrik	0.6	0.4	0.4	0.8	0.3	0.1
Gusht	0.3	0.4	0.5	0.5	0.6	0.2
Shtator	0.5	0.4	0.5	0.6	0.8	0.1
Tetor	0.2	0.5	0.4	0.7	1.1	0.3
Nentor	0.8	0.7	0.7	1.4	1.8	0.5
Dhjetor	1	0.8	0.8	1.5	2	0.9
Mes. 2024	0.71	0.45	0.43	0.97	1.14	0.33

Sasia e CO brenda vitit ka qenë nën vlerën e lejuar standarde 10 mg/m^3 (shiko fig. 7).




Fig. 7. Mesataret vjetore të CO, në AKS1, 2024

2.3 ZONA ZKS1 - Cilësia e ajrit

PM₁₀

Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat për vlerat mesatare mujore dhe vjetore të parametrin PM₁₀. Bazuar në të dhënat nga stacionet monitoruese është konstatuar se nuk ka pasur tejkalim të vlerave kufitare bazuar në vlerën standarde.

Nivele më të larta të PM₁₀ janë regjistruar në stacionin monitoruese të Gjilanit gjatë muajve janar dhe shkurt (shiko tabelën 9).

Tabela 9. Vlerat mesatare mujore të PM₁₀ në ZKS1, 2024

Muaji	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Brezovicë	Hani Elezit	Gjilan
Janar	18	31	36	21	2	26	42
Shkurt	19	32	33	18	6	25	42
Mars	12	21	19	12	9	14	21
Prill	12	19	15	13	8	12	13
Maj	9	12	12	8	9	9	8
Qershor	11	14	14	11	16	13	12
Korrik	16	10	17	10	17	12	12
Gusht	18	14	11	10	19	12	13
Shtator	11	14	8	9	9	10	11
Tetor	15	23	28	14	6	12	16
Nëntor	22	28	25	24	5	21	30
Dhjetor	19	28	29	24	-	18	30
Mes. 2024	15.17	20.50	20.58	14.50	9.64	15.33	20.83

Parametri PM₁₀, i cili ka qenë nën vlerat e lejuara sipas standardit vjetor që është 40 µg/m³ (shiko fig.8).




Fig. 8. Mesataret vjetore të PM₁₀ në ZKS1, 2024

PM_{2.5}

Bazuar në të dhënat e vlerësuara për PM_{2.5} nivele më të larta të PM_{2.5} janë regjistruar te disa stacionet monitoruese gjatë muajve të ndryshëm si:

- Mitrovicë -janar, dhjetor
- Pejë -janar, dhjetor
- Gjilan -janar, shkurt, nëntor, dhjetor. *Shiko tabelën 10.*

Tabela 10. Vlerat mesatare mujore të PM_{2.5}, në ZKSI, 2024

Muaji	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Brezovicë	Hani Elezit	Gjilan
Janar	16	26	30	19	2	23	38
Shkurt	15	22	22	13	5	18	34
Mars	9	13	12	8	6	10	17
Prill	6	9	8	5	5	6	9
Maj	5	7	7	5	7	6	6
Qershor	6	8	7	5	11	7	7
Korrik	8	7	7	6	14	7	8
Gusht	9	9	7	6	14	8	9
Shtator	7	10	6	6	7	6	8
Tetor	11	16	10	11	5	9	12
Nëntor	18	22	22	19	4	17	26
Dhjetor	17	25	26	21	-	16	28
Mes. 2024	10.58	14.50	13.67	10.33	7.27	11.08	16.83

Në stacionet monitoruese të zonës ZKSI mesatarja vjetore e parametrit PM_{2.5}, ka qenë nën vlerat e lejuara sipas standardit që është 25 µg/m³ (shiko fig. 9).




Fig. 9. Mesataret vjetore të PM_{2.5}, në ZKSI, 2024

Ozoni (O₃)

Vlerat më të larta të O₃ në mesatare mujore janë regjistruar në stacionin e monitorimit në Brezovicë (gjatë gjithë vitit), si dhe në lokalitete të tjera si Drenas, Pejë, Prizren, Hani i Elezit, Gjilan kryesisht gjatë stinës së pranverës dhe verës.

Në tabelën 11 janë paraqitur vlerat për mesataren mujore të O₃, në të cilën është vlerësuar se nuk ka pasur tejkalime të vlerave kufitare gjatë vitit 2024 (shiko tabelën 11).

Tabela 11. Vlerat mesatare mujore të O₃, në ZKSI, 2024

Muaji	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Brezovicë	Hani Elezit	Gjilan
Janar	45	25	35	24	75	35	36
Shkurt	49	27	46	47	82	48	41
Mars	56	36	57	56	86	52	52
Prill	61	37	70	71	94	61	60
Maj	63	28	65	65	89	57	62
Qershor	69	24	73	70	95	66	69
Korrik	78	38	91	65	106	81	79
Gusht	76	41	86	91	111	81	78
Shtator	59	24	62	38	90	52	37
Tetor	35	12	38	17	78	38	15
Nëntor	29	16	27	28	72	31	16
Dhjetor	29	15	19	22	-	28	15
Mes. 2024	54.08	26.92	55.75	49.50	88.91	52.50	46.67

Mesatarja vjetore e O₃, gjatë vitit 2024 ka qenë nën vlerat e lejuara standarde 120 µg/m³ (shiko fig. 10).




Fig. 10. Mesataret vjetore të O₃, në ZKSI, 2024

Dyoksidi i Sulfurit (SO₂)

Vlerat e parametrut SO₂ të monitoruar në stacionet e cilësisë së ajrit në zonën ZKS1, tregojnë se nuk ka pasur tejkalime të vlerave kufitare të lejuara (shiko tabelën 12).

Tabela 12. Vlerat mesatare mujore të SO₂, në ZKS1, 2024

Muaji	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Brezovicë	Hani Elezit	Gjilan
Janar	8	22	6	5	3	9	21
Shkurt	8	25	6	10	3	11	16
Mars	7	18	5	7	2	12	5
Prill	8	12	5	6	2	12	3
Maj	9	6	5	8	1	15	4
Qershor	3	4	3	9	2	22	2
Korrik	4	4	4	10	2	22	1
Gusht	7	3	4	14	4	5	2
Shtator	6	3	3	2	2	3	2
Tetor	8	3	3	2	2	3	4
Nëntor	10	4	5	3	3	3	10
Dhjetor	12	6	8	4	-	3	7
Mes. 2024	7.50	9.17	4.75	6.67	2.36	10.00	6.42

Përveç të dhënave për vlerat mujore të SO₂ të cilat nuk kanë pasur asnjë tejkalim kufitar, edhe sasia e SO₂, në mesataret vjetore ka qenë nën vlerën e lejuar të standardit 125 µg/m³ (shiko fig. 11).




Fig. 11. Mesataret vjetore të SO₂, në ZKS1, 2024

Dyoksidi i Azotit (NO₂)

Duke u bazuar në të dhënat e stacioneve monitoruese përgjatë vitit 2024, parametri NO₂ nuk është vërejtur se ka kaluar vlerat kufitare të lejuara.

Vlerat më të larta të NO₂ janë vërejtur tek stacionet e monitorimit në: Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan (shiko tabelën 13).

Tabela 13. Vlerat mesatare mujore të NO₂ në ZKSI, 2024

Muaji	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Brezovicë	Hani i Elezit	Gjilan
Janar	18	31	27	33	1	15	30
Shkurt	15	17	22	22	1	19	30
Mars	12	10	14	16	1	12	20
Prill	11	12	10	13	1	9	16
Maj	8	10	7	10	1	10	12
Qershor	7	12	7	10	1	12	11
Korrik	11	14	8	12	1	11	16
Gusht	16	12	11	13	2	13	19
Shtator	11	12	10	20	1	15	12
Tetor	15	16	16	24	1	17	9
Nentor	18	19	25	26	1	20	12
Dhjetor	18	19	26	23	-	18	12
Mes. 2024	13.33	15.33	15.25	18.50	1.09	14.25	16.58

Gjithashtu mesataret vjetore të parametrin NO₂, kanë qenë nën vlerën e lejuar standarde 40 µg/m³ (shiko fig.12).




Fig.12. Mesataret vjetore të NO₂ në ZKSI, 2024

Monoksidi i Karbonit (CO)

Në tabelë janë paraqitur të dhënat e cilësisë së ajrit, për mesataren mujore dhe vjetore të vitit 2024, të parametrut CO, në zonën ZKS1, si dhe në bazë të këtyre të dhënave është vlerësuar se nuk ka pasur tejkalime të vlerave kufitare të lejuara.

Vlera më e lartë në mesatare mujore është vërejtur në stacionin monitorues në Pejë, në muajin dhjetor - 2024 (shiko tabelën 14).

Tabela 14. Vlerat mesatare mujore të CO në ZKS1, 2024

Muaji	Drenas	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Brezovicë	Hani Elezit	Gjilan
Janar	0.8	1	1.3	1.2	0.7	1	1
Shkurt	0.5	0.9	1	1.1	0.3	0.6	0.8
Mars	0.5	0.3	0.8	0.8	0.2	0.4	0.4
Prill	0.5	0.3	0.8	0.4	0.2	0.2	0.1
Maj	0.6	0.3	0.2	0.4	0.2	0.3	0.2
Qershor	0.6	0.4	0.4	0.4	0.1	0.4	0.2
Korrik	0.8	0.4	0.7	0.7	0.1	0.4	0.2
Gusht	0.4	0.5	0.8	0.6	0.2	0.4	0.2
Shtator	0.5	0.6	0.5	0.4	0.2	0.4	0.2
Tetor	0.7	0.7	0.7	0.6	0.3	0.5	0.3
Nentor	0.7	0.9	1.6	1.2	0.3	0.7	0.7
Dhjetor	0.8	0.7	2	1.6	-	0.8	1
Mes. 2024	0.62	0.58	0.90	0.78	0.25	0.51	0.44

Në zonën ZKS1, CO i cila ka qenë nën vlerën e lejuar standarde që është 10 mg/m^3 (shiko fig. 13).




Fig.13. Mesataret vjetore të CO në ZKS1, 2024

2.4 Ditët me tejkalime për PM₁₀ gjatë vitit 2024

Duke u bazuar në të dhënat për ditët me tejkalime të PM₁₀ gjatë vitit 2024, rezulton se nuk ka pasur tejkalim të vlerës standarde vjetore prej 35 ditësh, me përjashtim të stacionit monitorues në Rilindje (Zona AKS1), ku është vërejtur një rritje në numrin e ditëve me tejkalim, afër vlerës standarde (33 ditë).

Ndërsa, nga krahasimi mes vitit 2023 dhe 2024 për numrin e ditëve me tejkalim të parametrit PM₁₀, të dhënat tregojnë se ky parametër ka qenë më i lartë në vitin 2023. Ndërkohë, në vitin 2024 është vërejtur një ulje e këtij parametri. Konkretisht, gjatë vitit 2024, numri i ditëve me tejkalim ka qenë 47 ditë më i ulët krahasuar me vitin 2023, duke treguar një përmirësim në cilësinë e ajrit për këtë parametër.

Tabela 15. Vlerat e ditëve me tejkalime për PM₁₀ gjatë vitit 2024

Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
IHMK	5	1	0	0	0	0	0	0	0	0	3	6	15
Rilindje	10	4	0	1	0	1	0	0	0	0	10	7	33
Drenas	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	2
Mitrovicë	6	2	0	1	0	0	0	0	0	0	1	6	16
Pejë	9	4	0	0	0	0	0	0	0	0	1	4	18
Prizren	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	4	7
Brezovicë	0	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0	-	2
Hani Elezit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjilan	9	8	0	0	0	0	0	0	0	0	4	5	26
Obiliq	8	2	0	0	0	0	0	0	0	0	4	6	20
Dardhishtë	3	1	0	0	0	0	0	0	0	0	3	1	8
Palaj	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Kodra Trimave	6	2	0	0	0	0	0	0	0	0	7	6	21
2024	59	25	1	3	0	1	0	0	0	0	34	46	169




Fig.14. Numrit i ditëve me tejkalime për PM₁₀, 2023 dhe 2024

2.5 Trendi i cilësisë së ajrit 2013-2024

Trendi i cilësisë së ajrit përfaqëson matjen mujore të cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë monitorimin e parametrave kryesorë (PM_{10} , $PM_{2.5}$, O_3 , SO_2 , NO_2 dhe CO) gjatë periudhës 2013–2024.

Bazuar në të dhënat e analizuara, konstatohet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ajrit gjatë katër viteve të fundit (2021, 2022, 2023, 2024), veçanërisht për parametrat PM_{10} , $PM_{2.5}$. Ndër këta parametra, rënia më e theksuar është vërejtur te PM_{10} . Në anën tjetër, ndryshe nga këta parametra, niveli i O_3 ka treguar një tendencë në rritje. Megjithatë, kjo rritje mbetet brenda kufijve të lejuar sipas vlerës standarde ($120 \mu g/m^3$). Viti 2024 shënon një përmirësim të mtejshëm të cilësisë së ajrit në krahasim me vitin e kaluar, si dhe një zgjerim të rrjetit të monitorimit.

Si përfundim, konstatohet se vlerat e të gjithë parametrave, pavarësisht disa luhatjeve, mbeten brenda kufijve të lejuar, në përputhje me Direktivën 2008/50 dhe Ligjin nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Tabela 16. Të dhënat e cilësisë së ajrit nga viti 2013 deri 2024

Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
PM_{10}	42.3	34.69	43.77	39.46	33.13	41.57	29.96	27.6	22.29	22.21	18.97	18.23
$PM_{2.5}$	28.86	18.73	33.87	17.91	25.36	25.43	20.75	20.58	16.66	16.06	14.11	12.98
O_3	59.9	41.37	38.09	47.66	26.22	45.18	43.02	48.99	50.57	47.05	47.81	50.59
SO_2	6.37	13.6	14.7	20.63	16.19	34.65	11.05	12.55	10.64	9.4	8.53	8.62
NO_2	15.57	16.56	21.45	27.35	26.22	26.45	23.91	15.04	12.25	15.12	13.52	13.7
CO	0.72	1.2	2.18	2.36	1.93	1.87	1.05	0.98	0.8	0.7	0.61	0.62




Fig. 15. Cilësia e Ajrit nga viti 2013 deri 2024

3. Vlerësimi i emisioneve ndotëse nga operatorët për vitin 2024

3.1 Emisionet në ajër nga Termocentralet Kosova A dhe B

Sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për Rregullat dhe Normat e Shkarkimeve në Ajër nga Burimet e Palëvizshme të Ndotësit, vlerat kufitare për emisionet janë:

- Pluhur 20 mg/Nm³
- SO₂ 400 mg/Nm³
- NO_x 400 mg/Nm³

Në Termocentralin “Kosova A”, parametrat për SO₂ dhe NO_x janë të llogaritur (me përjashtim të emisioneve të pluhurit që maten), ndërsa në Termocentralin “Kosova B” të gjithë parametrat janë të llogaritura.

Në njësitë A3, A4 dhe A5 të TC “Kosova A” janë instaluar pajisje për monitorim të vazhdueshëm të emisioneve të pluhurit (grimcave). Megjithatë, vlefshmëria e matjeve është e diskutueshme për shkak të mirëmbajtjes jo të rregullt të pajisjeve.

Në TC “Kosova B” janë vendosur pajisje për matje të vazhdueshme të emisioneve të pluhurit, SO₂ dhe NO_x, të cilat aktualisht nuk janë funksionale. Për rrjedhojë, emisionet e këtyre ndotësve llogariten dhe nuk maten drejtpërdrejt.

Emisionet e Pluhurit në TCA dhe TCB

Nga të dhënat për emisionet e pluhurit për TCA dhe TCB, vërehet se në të dy termocentralet ka pasur tejkalime të vlerave kufitare të lejuara (VKE) për pluhurin (*shiko fig. 16*).

Duhet theksuar se në TC “Kosova B” këto tejkalime janë dukshëm më të lartë krahasuar me TC “Kosova A”.




Fig.16. Mesataret mujore për emisionet e pluhurit në TCA dhe TCB, 2024

Emisionet e SO₂ në TCA dhe TCB

Analiza e të dhënave për emisionet e SO₂ në TCA dhe në TCB, kanë treguar se në TCA ka pasur tejkalime nga vlera kufitare e emisioneve (VKE), ndërsa në TCB nuk është vërejtur ndonjë tejkalim (shiko fig. 17).




Fig.17. Mesataret mujore për emisionet e SO₂ në TCA dhe TCB, 2024

Emisionet e NO_x në TCA dhe TCB

Bazuar në llogaritjen e të dhënave për emisionet e NO_x në TCA dhe në TCB në të dy termocentralet TCA dhe TCB ka pasur tejkalime nga vlera kufitare e emisioneve (VKE 400 mg/ Nm³), (shiko fig. 18).




Fig.18. Mesataret mujore për emisionet e NO_x në TCA dhe TCB, 2024

3.2 Emisionet në ajër nga Sharrcem

Normat për shkarkimet e ndotësve nga industria e Sharrcem janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021, i cili rregullon rregullat dhe kufizimet për shkarkimet në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë grafike të dhënat për emisionet e pluhurit, SO₂ dhe NO_x në Sharrcem.

- **Emisionet e pluhurit:**

- Emisionet e pluhurit te furra - mulliri i lëndës së parë;
- Emisionet e pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos.

Emisionet e pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë

Në figurën 19, janë paraqitur vlerat mesatare mujore të emisioneve të pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë në Sharrcem, nga shihet se vlerat janë shumë më të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve VKE 30 mg/Nm³.




Fig.19. Mesataret mujore për emisionet e pluhurit te furra - mulliri i lëndës së parë, 2024

Emisionet e pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos

Te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos, vlen të cekët se për bazë merret vlera kufitare e emisioneve (VKE) 20 mg/Nm³.

Vlerat mesatare mujore të emisioneve të pluhurit të ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos në Sharrcem për vitin 2024, janë shumë më të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve (VKE), (shiko fig. 20).




Fig.20. Mesataret mujore për emisionet e pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos, 2024

- **Emisionet e SO₂ te furra – mulliri i lëndës së parë**

Emisionet e SO₂ te furra – mulliri i lëndës së parë në operatorin Sharrcem gjatë vitit 2024, tregojnë se janë shumë më të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve (VKE). (Shiko Fig. 21).




Fig.21. Mesataret mujore për emisionet e SO₂ te furra - mulliri i lëndës së parë në Sharrcem, 2024

- **Emisionet e NO_x te furra – mulliri i lëndës së parë**

Në figurën 22, paraqitën vlerat mesatare mujore të emisioneve të NO_x te furra – mullirit i lëndës së parë në Sharrcem, nga shihet se nuk ka tejkalime në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve (VKE).




Fig.22. Mesataret mujore për emisionet e NO_x te furra – mulliri i lëndës së parë, 2024

3.3 Aktivitetet e Ferronikelit për vitin 2024

Sa i përket aktiviteteve të përgjithshme të Ferronikelit, gjatë vitit 2024 nuk janë zhvilluar aktivitete prodhuese, (pasi prodhimi është ndaluar që nga data 1 nëntor 2023). Kjo situatë pritet të vazhdojë për një periudhë të pacaktuar, si pasojë e kushteve të pafavorshme në treg. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar është kostoja e lartë e energjisë elektrike në tregun e Bashkimit Evropian – prej nga Ferronikeli furnizohet me energji, si dhe çmimet jo të favorshme të nikelit në tregun ndërkombëtar. Si rezultat, kostoja e prodhimit aktualisht është më e lartë se çmimi i shitjes në treg.

Duke marrë parasysh se gjatë vitit 2024 nuk ka pasur aktivitete prodhuese, nuk është realizuar as monitorimi i gjendjes mjedisore. Si rezultat, për këtë periudhë nuk është hartuar raport vjetor për gjendjen e mjedisit lidhur me aktivitetet e Ferroniklit.

4. Investimet në sektorin e ajrit për vitin 2024

Investimet për sektorin e ajrit nga buxheti i Republikës së Kosovës në vitin 2023-2026, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 17. Vlera e investimeve nga buxheti i Republikës së Kosovës

Lloji i investimit	Vlera totale	Viti
Mirëmbajtja e aplikacioneve për cilësinë e ajrit dhe informimi i publikut për parashikimin tregues të cilësisë së ajrit	252,756.00 €	2023-2026
Mirëmbajtja e stacioneve monitoruese për cilësinë e ajrit për periudhën 3 vjeçare	600,000.00 €	2023-2026

• Investimet nga donatorët

Investimet nga JICA-s për vitin 2024

Ndër investitorët e huaj më të rëndësishëm në sektorin e ajrit në Kosovë, veçanërisht në ngritjen e kapaciteteve për kontrollin ndotjes së cilësisë së ajrit, është Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA). Kjo agjenci, për periudhën 2022-2026, është e angazhuar në një projekt afatgjatë që synon zhvillimin e njohurive profesionale dhe përmirësimin e metodologjive për matjen dhe kontrollin e ndotjes së ajrit. Investimi i JICA-s konsiderohet një ndër ndërhyrjet më të strukturuar dhe serioze në këtë fushë, duke përfshirë trajnime për stafin teknik, furnizimin me pajisje moderne dhe përgatitjen e raporteve të standardizuara. Qëllimi kryesor i projektit është ndërtimi i kapaciteteve vendore për të siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe efektiv të monitorimit të ajrit. Kjo mbështetje është vlerësuar shumë nga institucionet vendore për shkak të ndikimit pozitiv në forcimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e të dhënave të cilësisë së ajrit. Në këtë mënyrë, JICA luan një rol kyç në përpjekjet e Kosovës për të përmbushur standardet mjedisore ndërkombëtare (shiko tabelën 17).

Tabela.18. Vlera e investimeve dhe periudha e projektit

Lloji i investimit	Vlera totale	Viti
Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit -faza e dytë	2,700,000 €	2022-2026

5. Efektet e ndotjes së ajrit në shëndet

Ndotja e ajrit përbën një nga kërcënimet më serioze për shëndetin publik në mbarë botën, me ndikime të drejtpërdrejta si në mirëqenien fizike ashtu edhe në atë mendore të njerëzve. Ndotja prek veçanërisht grupet më të ndjeshme të popullsisë, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe individët që vuajnë nga sëmundje kronike si astma dhe sëmundjet kardiovaskulare.

Burimet e ndotjes së ajrit janë të shumta dhe shpesh të pranishme në jetën e përditshme. Aktivitetet shtëpiake që përfshijnë përdorimin e teknologjive të vjetruara për ngrohje apo gatim, trafiku i rënduar, proceset industriale dhe zjarret pyjore janë ndër kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit. Përmes këtyre proceseve lëshohen ndotës të rrezikshëm si grimcat e imëta (PM₁₀ dhe PM_{2.5}), monoksidi i karbonit (CO), dioksidi i azotit (NO₂), ozoni troposferik dhe dioksidi i squfurit (SO₂).

Ekspozimi ndaj këtyre ndotësve lidhet ngushtë me një sërë problemesh shëndetësore, si sëmundjet e frymëmarrjes (bronkit kronik, infeksione të rrugëve të frymëmarrjes), dëmtimet e mushkërive, si dhe rritje të rrezikut për sëmundje të zemrës, goditje në tru dhe disa lloje të kancerit, përfshirë kancerin e mushkërive. Studimet e fundit kanë vënë në dukje se ndotja e ajrit ndikon edhe në zhvillimin neurologjik të fëmijëve, duke u shoqëruar me probleme në përqendrim, kujtesë dhe sjellje.

Përveç ndikimeve individuale, ndotja e ajrit ka pasoja të mëdha edhe për sistemin shëndetësor dhe ekonominë në tërësi. Rritja e rasteve të sëmundjeve shoqërohet me një numër më të madh vizitash spitalore dhe shpenzime të larta për kujdesin shëndetësor. Prandaj, është e domosdoshme marrja e masave për uljen e ndotjes dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

6. Rekomandimet

- Të zbatohet në mënyrë të plotë legjislacioni për kufizimin e shkarkimeve të ndotësve në ajër nga burimet stacionare dhe lëvizëse.
- Institucionet përgjegjëse, veçanërisht inspektoratet në nivel qendror dhe lokal, të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të operatorëve ndotës, për të siguruar respektimin e standardeve për emisionet ndotëse në ajër.
- Komunitatet të hartojnë dhe zbatojnë planet lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, në përputhje me gjendjen specifike në territori të tyre.
- Operatorët ndotës që ende nuk janë të pajisur me leje mjedisore, duhet të pajisen në afatin më të shkurtër të mundshëm.
- Të reduktohet sa më shumë përdorimi i lëndëve djegëse fosile në ekonomitë familjare, shkolla, institucione parashkollore dhe te operatorët ekonomik.
- Të zgjerohet sistemi i kogjenerimit të ngrohtores së qytetit të Prishtinës, por edhe të aplikohet në qytete të tjera të Kosovës.
- Qendrat e kontrollit teknik të automjeteve të jenë më rigorozë në verifikimin e normave të lejuara të shkarkimeve të gazrave ndotës.
- Të promovohet dhe përdoret më shumë transporti urban publik, duke reduktuar përdorimin individual të veturave.
- Të ndalohet në mënyrë të rreptë djegia e mbeturinave në çdo formë, përveç rasteve të lejuara me autorizim të veçantë.
- Të rritet numri i sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane dhe në hapësirat e degraduara.
- Të rriten investimet në sektorin e ajrit, me përkrahje të veçantë nga buxheti i Kosovës.
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) të realizojë vlerësime të rregullta vjetore për ndikimin e ndotjes së ajrit në shëndetin publik, duke u mbështetur në të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit.

7. Lista e shkurtesave

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

AMMK - Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

DVGJM- Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes Mjedisore

IHMK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

TCA - Termocentrali Kosova A

TCB - Termocentrali Kosova B

AQI - Indeksi i cilësisë së ajrit

BE - Bashkimi Evropian

OBSH - Organizata Botërore e Shëndetësisë

JICA - Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar

8. Lista e figurave

- Fig. 1. Lokacionet e stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit
- Fig. 2. Mesataret vjetore të PM_{10} , në AKS1, 2024
- Fig. 3. Mesataret vjetore të $PM_{2.5}$, në AKS1, 2024
- Fig. 4. Mesataret vjetore të O_3 , në AKS1, 2024
- Fig. 5. Mesataret vjetore të SO_2 , në AKS1, 2024
- Fig. 6. Mesataret vjetore të NO_2 , në AKS1, 2024
- Fig. 7. Mesataret vjetore të CO, në AKS1, 2024
- Fig. 8. Mesataret vjetore të PM_{10} , në ZKS1, 2024
- Fig. 9. Mesataret vjetore të $PM_{2.5}$, në ZKS1, 2024
- Fig. 10. Mesataret Vjetore të O_3 , në ZKS1, 2024
- Fig. 11. Mesataret vjetore të SO_2 , në ZKS1, 2024
- Fig. 12. Mesataret vjetore të NO_2 në ZKS1, 2024
- Fig. 13. Mesataret vjetore të CO në ZKS1, 2024
- Fig. 14. Numri i ditëve me tejkalime për PM_{10} , 2023 dhe 2024
- Fig. 15. Cilësia e Ajrit nga viti 2013 deri 2024
- Fig. 16. Mesataret mujore për emisionet e pluhurit në TCA dhe TCB, 2024
- Fig. 17. Mesataret mujore për emisionet e SO_2 në TCA dhe TCB, 2024
- Fig. 18. Mesataret mujore për emisionet e NO_x në TCA dhe TCB, 2024
- Fig. 19. Mesataret mujore për emisionet e pluhurit te furra - mulliri i lëndës së parë, 2024
- Fig. 20. Mesataret mujore për emisionet e pluhurit të ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos, 2024
- Fig. 21. Mesataret mujore për emisionet e SO_2 te furra - mulliri i lëndës së parë në Sharrcem, 2024
- Fig. 22. Mesataret mujore për emisionet e NO_x te furra – mulliri i lëndës së parë, 2024

9. Lista e tabelave

- Tabela 1. Vlerat e pragut alarmues për PM_{10} , O_3 , NO_2 , SO_2
- Tabela 2. Ndotësit e ajrit dhe efektet e tyre në mjedis dhe shëndet
- Tabela 3. Vlerat mesatare mujore të PM_{10} në AKS1, 2024
- Tabela 4. Vlerat mesatare mujore të $\text{PM}_{2.5}$ në AKS1, 2024
- Tabela 5. Vlerat mesatare mujore të O_3 në AKS1, 2024
- Tabela 6. Vlerat mesatare mujore të SO_2 në AKS1, 2024
- Tabela 7. Vlerat mesatare mujore të NO_2 , në AKS1, 2024
- Tabela 8. Vlerat mesatare mujore të CO , në AKS1, 2024
- Tabela 9. Vlerat mesatare mujore të PM_{10} në ZKS1, 2024
- Tabela 10. Vlerat mesatare mujore të $\text{PM}_{2.5}$, në ZKS1, 2024
- Tabela 11. Vlerat mesatare mujore të O_3 , në ZKS1, 2024
- Tabela 12. Vlerat mesatare mujore të SO_2 , në ZKS1, 2024
- Tabela 13. Vlerat mesatare mujore të NO_2 në ZKS1, 2024
- Tabela 14. Vlerat mesatare mujore të CO në ZKS1, 2024
- Tabela 15. Vlerat e ditëve me tejkalime për PM_{10} gjatë vitit 2024
- Tabela 16. Të dhënat e cilësisë së ajrit nga viti 2013 deri 2024
- Tabela 17. Vlera e investimeve nga buxheti i Republikës së Kosovës
- Tabela 18. Vlera e investimeve dhe periudha e projektit

Raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë 2024
është përgatitur nga Divizioni për Vlerësim të Gjendjes së Mjedisit &
Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit
në mbështetje edhe të njësive tjera të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Raportin e përgatiten:

Tafë Veselaj, PhD - Udhëheqës i Divizionit të Vlerësimit të Gjendjes së Mjedisit
MSc. Musli Kozhani - Zyrtar për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit
Ajet Mahmuti - Zyrtar për monitorim të ajrit dhe zhurmës
Msc. Arbnora Nikolla - staf mbështetës

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 74 093, email: ammk@rks-gov.net
www.ammk-rks.net